Lezhë, më 13.06.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 13.06.2022, në orën 13:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen jashtë radhe, të kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, pasi aktet e paraqitura nuk presin dot mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Ende pa filluar mbledhja kërkoi fjalën zv/kryetari i Bashkisë z. Ermal Pacaj i cili kërkoi mirëkuptimin e këshilltarëve për të shtuar për shqyrtim një projekt vendim që ka të bëjë me fondet buxhetore për sportin dhe që është i ndërlidhur me projekt vendimin në pikën 4 të rendit të ditës të miratuar, për të cilin këshilltarët ranë dakord.

Kryetari i këshillit filloi mbledhjen dhe lexoi rendin e ditës me pikën shtesë të propozuar nga zv/kryetari i Bashkisë.

Ernest Rakaj: E hedhim në votim

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent (22).

→ U largua këshilltari Hasan Muça.

Ernest Rakaj: Fillojmë me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës, që është projekt-vendim "Për një ndryshim në VKB nr. 177, dt. 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024"".

I japim fjalën zv/kryetarit të Bashkisë.

→ Erdhi Kryetari i Bashkisë z. Pjerin Ndreu.

Ermal Pacaj: Kemi sjellë në këshill këtë p/vendim

për ndryshimin e buxhetit. Kërkojmë nga Këshilli Bashkiak t'na autorizojë që të shtojmë për sezonin turistik një numër prej 20 punonjësish, të cilët do i shërbejnë Bashkisë së Lezhës për mirëmbajtjen e zonës turistike të Shëngjinit dhe të Tales, pra gjithë vijën bregdetare. Pastrimi dhe mirëmbajtja do bëhen 2 herë në ditë te të gjitha akset kryesore që kanë impakt te turizmi. Kjo në vijë në përgjithësi.
Ernest Rakaj: Faleminderit Ermal.
Ke dikush diçka për të shtuar?
Agostin Marku: Në parim jam dakord. Unë do isha që të shtohet një pikë në vendim mqs në relacion është për efektin. Këtu thotë kontratë 3-mujore por të përcaktohet partë 15 qershor - 15 shtator p.sh.
Ermal Pacaj: Kjo mund të bëhet edhe më 16, edhe më 17, ideja është që 15 qershori të jetë si deadline, edhe për shkak të konfirmimit.
Ernest Rakaj: E kalojmë vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës që është projekt vendim "Për disa shtesa e ndryshime në VKB nr. 157, dt. 17.11.2021 "Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat

e ngjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së pena-
liteteve ndaj kundravajtësve".

→ Fjalën e merr kryetari z. Pjerin Ndreu.

Pjerin Ndreu: Përshëndetje të gjithëve.
Ne si bashki, jemi gjetur në një problematikë të cilën e kemi krijuar vetë, për mosrakordim mes drejtimit dhe Drejtorisë së Taksave, me idenë për mos të ndërhyjmë në gjëra teknike. Pati penalitet masiv të gjithë bizneseve të vogla me 200 mijë lekë të gjitha i cili në disa raste ne ka rezultuar të jetë arbitrar, pa njoftuar. Diçka nuk ka funksionuar. Ama ky është penalitet, nuk është taksë ose tarifë. Penaliteti, është në politikën e Bashkisë për në një moment të caktuar, edhe shikohet për nuk është i duhuri, edhe për shkak të ankesave të vazhdueshme të biznesit, ne kemi menduar për me vendim Këshilli me e hap. Kështu i shërbejmë komunitetit, biznesit. Unë kam qenë i shpejtësuar bashkë me stafin se si do e zgjidhim. Ka pasë një mospërfshi në Drejtorinë e Taksave, Unë mendoj për me vendim Këshilli, ne ta lehtësojmë biznesin nga ky penalitet për ka qenë në mënyrë masive dhe shumë shpesh arbitrare.

Rigels Nicaj: Te pika e pasë, jam dakord me faljen e penaliteteve, duke qenë se dhe

biznesi vjen nga një vështirësi. Ama këtu te pika e dytë "Tarifa e parkimit të automjeteve" me sa kam arritë me kuptu unë, këtu i është dhënë e drejta bizneseve, të zënë parkim pa limit. Unë mendoj që kjo duhet të rishikohet, të ketë një limit, se nuk mund të jenë njëlloj një hotel e një këmbim valute p.sh.

→ Erdhi këshilltari Klejvi Hoxhipi.

Ermal Pacaj: Mund të marrin më shumë se 1 parkim. Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Lezhë sheh mundësinë nëse nuk ka probleme në dhënien e më shumë se një. Bizneset do shprehin gatishmërinë për të marrë vendparkimet që kanë para vetes.

Pjerin Ndreu: Ta specifikojmë, sa ka ballorje e biznesit, aq të marrin.

Rigels Nicaj: Do lindin probleme kështu, ashtu siç ka pasur me shezllonet, po ia miratuam pa limit.

Ermal Pacaj: Drejtoria e Shërbimeve e vë në sitë këtë gjë, nuk është nevojë me e lidhë me VKB, numrin se sa do marrë secili biznes, kemi thënë pa limit, por ai nuk mund të marrë gjithë pjesën sepse D. e Shërbimeve ka një rregullore që e ndjek këtë gjë.

Agostin Marku: Parimisht për pikën 1 nuk jam dakord për një arsye, sepse në fakt hapësirat publike janë problem në Bashkinë

e Lezhës. N.p.s do heqim penalitetet do tarren të fitrë dhe hapësirat publike i kemi të zëna. Prandaj dhe ndonjëherë kërkojmë që të vijnë specialistët këtu, se nuk është e thënë të vijnë Kryetari e zv/kryetari. Se është kjo gjëbë për atë perimdhë dhe konkretisht ku, në cilat zona më shumë dhe së fundmi, dhe n.p.s doni të kaloni dhe i shërben punës, unë mendoj që si pika a dhe pika b janë në kontradiktë midis tyre. Nuk është formulimi i saktë. N.p.s doni të hiqni si penalitet shkronjën.

Ermal Pacaj: ky nuk po hiqet krejt si penalitet, ky qëndron si penalitet.

Pjerin Ndreu: ke njëfarë të drejte Agostini. Duhet vënë me perimdhë këtu, mund të ndryshojmë.

Agostin Marku: Ti thua: pika a - ishte N.p.s qëndron si penalitet mos u merr me të. Shto një paragraf te penalitetet dhe specifikojë këtu e shtjellizon ti.

Për sa i përket çështjes së dytë të pallimit, unë jam dakord në parim, por mos ta lëmë në përfundim, sepse edhe abuzohet. Mund të futni një kriter, p.sh hapësirë para resortit.

Ermal Pacaj: këto janë kritere që qëndrojnë në D. e shërbimeve.

Agostin Marku: Ermal, po mundoheni me dhënë zgjidhje, por do krijoni probleme. Është rrezik, bie fjala me ta marrë ty e me ia shitë tjetrit. Do luajë rolin e sekserit. Kur e përcakton ti, edhe ndihmon biznesin, edhe mbush arkën.

Pjerin Ndreu: Jam dakord edhe unë. Kufizim duhet vendosur. Ama është dhe diçka. Një biznes që ka përkim nëntokësor, pavarësisht se e ke përballë, nuk e merr. Atëherë ç'do bëjmë? Kujt do ia japim.

Agostin Marku: Ermal, do bësh vendimin të pazbatueshëm.

Ermal Pacaj: Në paketën fiskale ne e shtesim si vendparkim, jo si hapësirë publike. Kemi rastin kur biznesi merr ato që ka përballë dhe ato në anëzore nuk i merr ai tjetri, por i merr ky, pse ta përkufizoj.

Rigels Nicaj: Unë e shoh burim debati.

→ Erdhi këshilltari Hasan Muça.

Ermal Pacaj: Bashkia ka letra i mungojnë 50 mln lekë në vit prej asaj historie.

Pjerin Ndreu: Mos u bëni merak se edhe me ia thënë, merre fitimë rrugën, nuk e merr, se e ka merak mos me pagu lekë, madje edhe ato që do ia lënë ballore, s'kanë për t'i marrë. Më shumë është gjë tjetër

se si e interpretom bashkia. Unë jam partizan që të vëmë në fuqi, që do marrë sipas se ka bellojë e biznesit.

Ermal Pacaj: Ne sot që flasim kemi 12 subjekte për 35 vende parkimi që s'po na japin dot vetëm për këtë gjë.

Afestin Marku: Rregulloni pikën 1 të paketën.

Pjerin Ndreu: Të bëjmë një formulim të tillë: Falen të gjitha gjobat që i janë vendosur biznesit për punimet në fjalë.

Në paketën fiskale do gjetë gjë.

Unë kam dhënë urdhër që të hiqen që një që u vunë. Jo hiqet, jo s'hiqet. Po si i ke vendos gjobë kur nuk ke mbajt akt-konstatim.

Disa kanë penë në proces aplikimi në bashki, u ka kërcit gjoba. Janë ca sjellje që nuk më vijnë për shtat. dhe për këtë arsye ne kemi bërë ndryshime dhe te Drejtoria e Taksave.

Është një ndër drejtoritë që s'ka funksionuar në nivelin e duhur.

Ernest Pacaj: E kalojmë në votim me propozimin për ndryshimin e pikës 1.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent.

Kalojmë për shqyrtim te pika 3 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përse-masejen e Bashkisë Lezhë në subjekte me kompetenca të përbashkëta me pëllim

kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura".

Pjerin Ndreu: Kjo është detyrim, është me vendim qeverie që ujësjellësat të kalojnë të gjitha në bazë Qarku, po bëhet një organizim i ri dhe jemi të detyruar të miratojmë. Në gjithë Shqipërinë vetëm ne kemi ngelur. Lezha, Mirdita dhe Kurbini janë aksionerë në një Ujësjellës që drejtohet në bazë Qarku. Kjo është ideja pak a shumë, pa hyrë në çështje teknike.

Agostin Marku: Meqë është në bazë Qarku, këtu autorizohet kryetari i Bashkisë i aksioner i vetëm për pjesën e Lezhës.

Pjerin Ndreu: Ky jep leje që ata të votojnë me procedurat.
Do vijë tjetër gjë kur të votojë procedura në lidhje me Mirditën e Kurbinin.

Agostin Marku: Ti thua vetëm në parim?

Pjerin Ndreu: Po, thjesht në parim.
Japim lejen që jemi dakord. Por kaq.

Ernest Rakaj: E kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë

Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e

prioritetit për "Financimin e shoqatave sportive të federuara me objekt futbollin" për të përfaqësuar Lezhën në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të nxitur të rinjtë e talentuar në futboll në Bashkinë Lezhë".

Pjerin Ndreu: Bashkia Lezhë ka bërë disa lëvizje për shumë sportet. Ne kemi arritur rezultate dhe vazhdojmë të arrijmë. Që të flasim troç, ne kemi pasur mosmarrëveshje në mënyrën se si komunikon bashkia me klubin e futbollit, të cilat kanë lindë dhe pasojat e veta, derisa jemi ulur dhe kemi përcaktuar ligjërisht pikat. Bashkia do të jetë pjesë dhe do të ndjekë fitues procedurën e shpenzimeve për futbollin. Futbollin duhet ta ringjallim. I kemi mundësitë. Për t'i dhënë stimulim, kemi hapur një shumë nga projektet dhe ia kemi dhënë futbollit. Bashkia do luajë dhe rolin e interlokutorit me donatorë të ndryshëm

→ Këshilltari Alban Brucka mbajti fjalën e tij ku vuri theksin në nevojën e investimeve infrastrukturore për Stadiumin, për aneksin.

Pjerin Ndreu: Stadiumi i Lezhës do ikë prej aty. Ne do bëjmë stadium të ri. Derisa të

bëhet, vazhdojmë punën në stadiumin që është
Unë e di se duhen shumë gjëra
Duhet edhe pallat sporti.
Por do kohën e vet çdo punë.
Buxhetet e bashkisë janë të sforcuara
Kaluam tërmet, kaluam pandemi, erdhi
dhe kriza e luftës.
Albon Bruka: Me një përqindje shumë të vogël
që mund të japim ne, mund të marrim një
përqindje shumë të madhe nga federata
për investimet.
Pjerin Ndreu: Jam në komunikim me Presidentin
e Federatës së Futbollit, edhe me Komitetin
Olimpik, edhe me qeverinë. Unë i kam bërë
hapat e mi dhe ne shpresojmë që t'i bëjmë
gjërat tamam. Të bëjmë një gjë që i shërben
një herë e mirë Lezhës.
Albon Bruka: Kryetar, unë po flas për një
aneks, i cili është fare i thjeshtë për t'u bërë.
Pjerin Ndreu: Aneksin do ia kërkoj unë
Federatës që ta sponsorizojë.
Rigels Nicaj: Stadiumi do ribëhet?
Pjerin Ndreu: Nuk është një çështje që
bëhet sot. Stadiumi do lëvizë që aty
kur t'i vijë projekti.
Rigels Nicaj: Unë jam pro sportit por jam
që të shkojnë gjërat aty ku duhet.

Përin Ndreu: Unë kam vendosur rregulla.
Sot, po, jemi ulur, kemi rënë dakord që
do shkojmë drejt zgjerimit të futbollit edhe
për kontribut në blerje lojtarësh, infrastrukturë,
vajtje-ardhje, hoteleri etj.
Alben Bruka: Kryetar, unë jam krejt dakord
me këto për sa thamë, por për disa ndërhyrje
të vogla është e nevojshme. Ne kemi hallin
me fitu brezat e rinj.

P. Ndreu Aneksi do sistemohet për ti mos të çedoshë në
ndeshje edhe kur stadiumi të lëvizë për etj.
Për shpejt, do kërkojmë terrene sportive për
e kenë projektin etj.

Afestin Marku: Unë mendoj se është periudha
e duhur sepse është para fillimit të sezonit
futbollistike. Duhet të investohet në masi-
vizimin e këtij sporti në Lezhë. Përvojë
është, por edhe në rritjen e cilësisë.
Të fillojmë me këtë, me transparencë të plotë.
Besoj se do ndikojë te cilësia e futbollit, do
afrojë edhe tifozerinë, në stadiumin e Lezhës.

Ernest Roka: Mepo nuk ke dikush tjetër diçka
për të shtuar, e kalojmë p/vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë për shqyrtim te pika e fundit për
kemi sot; te pika për shtuar në rendin e
ditës, që është p/vendimi "Për një ndryshim

në V.K. Bashkiake nr. 177, dt. 23.12.2021 "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022 - 2024"" për ka lidhje me p/vendimin për klubin në lidhje me sportin e futbollit, për të cilin u diskutua dhe sqarimet.
E kalojmë në votim
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
Ernest Rakaj